



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.64

14 maj

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 123
datë 11.5.2009

Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër të huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEDB) për financimin e programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, malore”

2897

Udhëzim i MMPAU
nr.2, datë 14.5. 2009

Për kriteret e konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor

2912

LIGJ
Nr.10 123, datë 11.5.2009

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES KUADËR TË HUASË NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË
EUROPËS (CEDB) PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E
QËNDRUESHËM TË ZONAVE RURALE, MALORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja kuadër e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEDB) për financimin e programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, malore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.6164, datë 13.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

F/P 1649 (2008) A

MARRËVESHJE KUADËR HUAJE

**NDËRMJET BANKËS SË ZHVILLIMIT TË KËSHILLIT TË EVROPËS
DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Banka e Zhvillimit të Këshillit të Evropës, Organizatë Ndërkombëtare, Paris (këtu quhet CEB), nga njëra anë
dhe

Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministra e Financave, Blvd. Dëshmorët e Kombit, Tirana, Republika e Shqipërisë, (këtu quhet Huamarrësi),

- *Duke pasur parasysh* kërkesën e paraqitur nga Qeveria Anëtare e Shqipërisë të datës 30/06/2008;

- *Duke pasur parasysh* Protokollin e Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës;

- *Duke pasur parasysh* Rezolutën e Këshillit Administrativ të CEB-it: 1495 (2006);

- *Duke pasur parasysh* Rregulloret e Huasë të CEB-it, të datës qershor 2006 (këtu quhen Rregulloret e Huasë).

Kanë rënë dakord si më poshtë:
Përkufizime

“Alokimi i një Transhi” (këtu quhet edhe “Alokim” ose “I alokuar”) është alokimi i një Transhi nga Huamarrësi nëpërmjet PIA-s në pjesët përbërëse të Projektit (identifikuar nëpërmjet një tabele standard të bashkangjitur kësaj Marrëveshjeje Kuadër Huaje) edhe nëse një Transh i tillë nuk është disbursuar tek përfituesit fundorë.

“Data e Parashikuar e Përfundimit të Projektit” është data, sipas përcaktimit nga Huamarrësi në kohën e aprovimit të Projektit nga Këshilli Administrativ i CEB-it ose Komiteti i tij Ekzekutiv, në të cilën Huamarrësi parashikon që të jetë alokuar e gjithë huaja e CEB-it tek përfituesit e fundit, sipas përcaktimit në Nenin 3.3.

“Ditë Pune” është një ditë në të cilën funksionon Sistemi TARGET ((Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer System).

“Data e Mbylljes” është data që është gjashtë muaj pas Datës së Parashikuar për Përfundimin e Projektit, sipas parashikimit në Nenin 3.3.

“EURIBOR” (Euro Interbank Offered Rate) është norma me të cilën depozitat ndër-bankare me afat në Euro Brenda zonës së Euros ofrohet nga një bankë kryesore tek një bankë tjetër kryesore. Kjo sponsorizohet nga Federata Bankare Evropiane, e llogaritur nga Reuters dhe publikohet çdo ditë pune në Bruksel, në orën 11 00 të paradites në faqen e Reutersit EURIBOR01.

Përfitues i Fundit është subjekti moral ose juridik apo grupi social që përfiton nga efektet sociale të Projektit.

“Konventë e Modifikuar e Ditës Pasuese të Punës” është një konventë nëpërmjet së cilës nëse një datë e caktuar bie në një ditë që nuk është Ditë Pune, kjo datë do të jetë dita e parë pasuese që është Ditë Pune, përveç kur ajo ditë është në muajin pasues kalendarik, ku në këtë rast ajo datë do të ishte dita e fundit para kësaj dite që është Ditë Pune;

“Projekt” është programi me shumë projekte, që përbëhet nga një sërë nën-projektesh, siç përshkruhet në Shtojcën I.

“Agjencia e Zbatimit të Projektit (këtu quhet PIA)” është Fondi i Financimit për Zonat Malore (MAFF), që, në sajë të delegimit nga Huamarrësi, zbaton dhe menaxhon Projektin.”

“Transh” është shuma e disbursuar ose që duhet të disbursohet nga Huaja.

Neni 1 Kushtet

Huaja jepet sipas kushteve të përgjithshme të Rregulloreve të Huasë dhe sipas kushteve të veçanta të caktuara nga kjo marrëveshje kuadër huaje (këtu quhet Marrëveshja), Shtojcat e saj dhe letrat e saj shoqëruese (këtu quhen Letrat Shoqëruese).

Neni 2 Projekti

CEB-i i jep Huamarrësit, i cili pranon, një hua (këtu quhet Huaja) për financimin e pjesshëm të F/P1649 (2008) të aprovuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it në 21 nëntor 2008 dhe në lidhje me Projektin për financimin e pjesshëm të projekteve të investimeve prodhuese në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të), veçanërisht në zonat rurale, të zbatuar nga PIA, në kontekstin e “Programit për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Zonat Malore Rurale”.

Huaja jepet nga CEB-i duke patur parasysh detyrimin që merr përsipër Huamarrësi për ta zbatuar atë vetëm për financimin e Projektit të përshkruar në Shtojcën 1 (këtu të quajtur Projekti), dhe për të zbatuar Projektin sipas kushteve që janë detajuar në Shtojcën përkatëse.

Çdo ndryshim në mënyrën se si zbatohet Huaja nëse nuk ka marrë pëlqimin e CEB-it mund të çojë në pezullimin, anulimin ose shlyerjen e parakohshme të Huasë, sipas kushteve të Neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të Rregulloreve të Huasë.

Neni 3 Huaja

3.1. Kushtet financiare

Shuma e Huasë së dhënë është:

- 5 000 000 Euro
Pesë milion Euro

Ajo disbursohet në Transhe.

Për secilin Transh, shuma, norma e interesit, data e disbursimit, periudha e shlyerjes (afatet mund të jenë deri në 15 vjet duke përfshirë një periudhë deri në 5 vjet) dhe llogaritë e secilës pale për dërgimin përcaktohen së bashku nga Huamarrësi dhe CEB-i.

Një Letër Shoqëruese që përcakton këto kushte hartohet në momentin e disbursimit kryesisht në formën e përcaktuar në Shtojcën 2a dhe 2b.

3.2. Disbursimi

CEB-i e disburson Huanë minimumi në dy Transhe. Shuma e secilit Transh përcaktohet në pajtim me kapacitetin përthithës të Projektit.

Disbursimi i parë duhet të kryhet brenda 12 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje sipas përcaktimit në Nenin 15.

Transhi i parë nuk është më shumë se 1 milion Euro.

Çdo Transh pasues mund të disbursohet vetëm pasi Huamarrësi t'i konfirmojë me shkrim CEB-it, në përmbushje të Nenit 4.2.2 më poshtë, që Transhi i mëparshëm është alokuar plotësisht.

3.3 Data e Parashikuar për Përfundimin e Projektit dhe Data e Mbylljes

Data e Parashikuar për Përfundimin e Projektit është 30 qershori 2011.

Data e Mbylljes është 31 dhjetori 2011. Me kalimin e kësaj date, dhe me njoftimin e CEB-it drejtuar Huamarrësit, nga Huamarrësi nuk mund të bëhet asnjë tërheqje tjetër.

3.4. Hollësi për pagesën

Të gjitha shumatat që duhet të shlyhen nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje paguhet në monedhën e secilit Transh në numrin e llogarisë së komunikuar nga CEB-i Huamarrësit në momentin e disbursimit.

Huamarrësi ose banka e udhëzuar nga Huamarrësi, sipas rastit, i dërgon një njoftim pagese me shkrim CEB-it të paktën pesë ditë pune para pagesës së çdo shume që është e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

Çdo pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje bëhet në një Ditë Pune në pajtim me Konventën e Modifikuar të Ditës Pasuese të Punës.

Neni 4

Monitorimi i Huasë dhe Projektit

4.1. Përdorimi i Huasë

4.1.1. Afati

Transhet duhet të alokohen nga Huamarrësi nëpërmjet PIA-së në Projekt brenda 18 muajve pas çdo disbursimi.

Pjesa e të ardhurave të Huasë që nuk janë alokuar brenda një afati të tillë duhet t'i kthehen CEB-it, jo më vonë se brenda 30 ditëve.

Huamarrësi merr përsipër të përballojë shpenzimet që rrjedhin nga kjo shlyerje. Këto shpenzime janë të barabarta me ato që duhet të pësojë CEB-i për shkak të ri-investimit të së njëjtës shume në datën e shlyerjes për periudhën e mbetur të huasë origjinale si dhe çdo shpenzim përkatës. Norma e ri-investimit përcaktohet nga CEB-i në bazë të kushteve të tregut në datën e shlyerjes dhe për periudhën në fjalë. Kështu shpenzimet llogariten duke marrë parasysh diferencën ndërmjet normës origjinale dhe asaj të ri-investimit.

Për më tepër, nëse një transh i disbursuar nga CEB-i nuk alokohet në Projekt ose alokohet vetëm pjesërisht në të brenda afatit të përmendur në paragrafin e parë të mësipërm, kjo do të përbënte një ngjarje të renditur në Nenin 3.3-h të Kapitullit 3 të Rregulloreve të Huasë dhe mund të çojë në pezullimin, anulimin ose shlyerjen e parakohshme të Huasë sipas kushteve të Neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të Rregulloreve të Huasë.

4.1.2. Zbatimi i Projektit

Huamarrësi cakton Fondin e Financimit të Zonave Malore (MAFF) si PIA. Huamarrësi ia jep huanë e CEB-it si hua PIA-s (nën një Marrëveshje Huaje Dytësore) për të financuar një pjesë të huadhënies së saj tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me të njëjtat afate dhe kushte. Huamarrësi ia jap shumat e huasë PIA-s në monedhën lokale dhe duke bërë këtë ai merr përsipër riskun e këmbimit të monedhës. Kufiri maksimal i dhënies së nën-huasë nga MAFF-i përfituesve të fundit caktohet në 60 000 Euro. Megjithatë, përgjegjësia për të përmbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje i mbetet Huamarrësit.

4.1.2.1. Detyra e kujdesit

Huamarrësi tregon të gjithë kujdesin dhe vëmendjen dhe ushtron zakonisht të gjitha mjetet e zbatueshme, veçanërisht mjetet financiare, teknike, sociale dhe menaxhuese dhe ato në lidhje me mbrojtjen e ambientit, që do të jenë të nevojshme për zbatimin e duhur të Projektit.

4.1.2.2. Kostoja e rritur ose e rishikuar e Projektit

Nëse kostoja e Projektit, sipas përshkrimit në Shtojcën 1 të bashkangjitur, rritet ose rishikohet për një arsye të caktuar, Huamarrësi nëpërmjet PIA-s siguron që burimet shtesë financiare për përfundimin e Projektit të jenë në dispozicion.

Në çdo rast, financimi i pjesshëm nga CEB-i nuk është më shumë se 50% e kostos së përgjithshme të Projektit, duke përjashtuar interesin dhe detyrimet financiare, siç përcaktohen në Shtojcën 1.

4.1.2.3. Tregueshmëria e CEB-it

Huamarrësi, nëpërmjet PIA-s, u tregon Përfituesve të Fundit që Projekti financohet pjesërisht nga CEB-i duke përfshirë, ndër të tjera, referimet për CEB-in në marrëveshjet e huasë me Përfituesit e Fundit, që lidhen nga PIA me secilin Përfitues të fundit. Huamarrësi, nëpërmjet PIA-s, do t'i referohet gjithashtu Projektit në deklaratat përkatëse për shtyp dhe deklaratat e tjera publike në faqen e tij të internetit dhe kudo.

4.1.2.4. Sipërmarrje të tjera

Huamarrësi, për më tepër, merr përsipër që:

Zbatimi i Projektit të përputhet me të gjitha rregullat përkatëse mbi mashtrimin, korrupsionin dhe pastrimin e parave;

Zbatimi i Projektit nuk çon në ndonjë shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Kartës Sociale Evropiane;

Projekti të përputhet me parimet e Menaxhimit të Ambientit të CEB-it (Shtojca 3).

4.1.3. Prokurimi

Në lidhje me investimet në sektorin privat, Huamarrësi është i ndërgjegjshëm që CEB-i u rekomandon përfituesve që ata të përdorin, sipas rastit dhe nëse është e zbatueshme, procedurat e ofertimit konkurrues, veçanërisht për kontratat kryesore.

4.2. Kërkesat për informacion

4.2.1. Informacioni në lidhje me Projektin

Huamarrësi, nëpërmjet PIA-s, mban regjistra llogarish për Projektin që janë në pajtim me standardet ndërkombëtare që tregojnë, në çdo moment, gjendjen e progresit të Projektit, dhe që shënon të gjitha operacionet e bëra, dhe identifikon sendet pasurore dhe shërbimet e financuara me ndihmën e Huasë.

Huamarrësi nëpërmjet PIA-s merr përsipër të reagojë brenda një periudhe të arsyeshme ndaj çdo kërkesë për informacion nga CEB-i dhe t'i japë atij çdo dokument që CEB-i e konsideron të nevojshëm dhe mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për zbatimin e përshtatshëm të Marrëveshjes, veçanërisht në lidhje me monitorimin e Projektit dhe përdorimin e Huasë.

Huamarrësi informon CEB-in menjëherë për çdo ndryshim ligjor ose nënligjor në sektorin ekonomik që prek Projektin dhe, në kuptimin e përgjithshëm, për çdo ngjarje që mund të ketë ndikim në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje. Çdo ndryshim ligjor ose nënligjor në sektorin ekonomik që ka një efekt material negativ mbi Projektin do të përbënte një ngjarje të renditur në Nenin 3.3-h të Kapitullit 3 të Rregulloreve të Huasë dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose shlyerjen e parakohshme të Huasë sipas kushteve të Neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të Rregulloreve të Huasë.

4.2.2. Monitorimi

4.2.2.1. Identifikimi i nën-projekteve të përshtatshëm

Pas çdo disbursimi nga CEB-i, Huamarrësi nëpërmjet PIA-s i dërgon CEB-it për aprovim, brenda afatit të përcaktuar në Nenin 4.1.1. më sipër, një tabelë renditëse/përmbledhëse që paraqet elementët minimalë të duhur për të identifikuar nën-projektet e përshtatshëm. Shtojca 4 paraqet një formular për tabelën renditëse/përmbledhëse. Mund të përdoren formate alternative që përmbajnë të njëjtin informacion.

4.2.2.2. Raportet monitoruese

Për secilin Transh të disbursuar nga CEB-i, deri në Alokimin e plotë të Transhit, Huamarrësi, nëpërmjet PIA-s, i dërgon CEB-it një raport monitorimi:

- dymbëdhjetë muaj pas disbursimit ose para çdo kërkesë për një Transh pasues, cilado të jetë më parë. Ky raport duhet të konsiderohet i pranueshëm nga CEB-i me qëllim që të autorizojë çdo disbursim të mëtejshëm; dhe

- në momentin e alokimit të plotë të Transhit brenda afatit të treguar në Nenin 4.1.1.

Shtojca 5 paraqet një format që tregon informacionin minimal që kërkohet nga CEB-i për raportet e monitorimit. Mund të përdoren formatet alternative që përmbajnë të njëjtin informacion.

Në çdo rast, raportet e monitorimit trajtojnë:

- gjendjen e alokimit të Transheve të disbursuar të Huasë;
- kushtet e zakonshme të huave të dhëna Përfituesve të Fundit (kushtet e nën-huasë); dhe
- arritjet e matshme fizike/sasiore dhe ndikimin social të Projektit.

4.2.3. Misionet e monitorimit

Huamarrësi nëpërmjet PIA-s merr përsipër të pranojë pozitivisht çdo mision monitorimi që kryhet nga punonjësit e CEB-it ose konsulentë të jashtëm të punësuar nga CEB-i dhe të ofrojë të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm për misionet e tyre të monitorimit, duke lehtësuar çdo vizitë të mundshme në vendin e Projektit. Veçanërisht, CEB-i mund të zhvillojë një auditim në terren të llogarive të Projektit, që kryhet nga një ose më shumë konsulentë sipas zgjedhjes së tij me shpenzimet e Huamarrësit, në rastin e mospërmbushjes nga Huamarrësi në lidhje me ndonjë nga detyrimet e tij për këtë Hua.

4.2.4. Informacioni në lidhje me PIA-n

Huamarrësi siguron që PIA t'i dorëzojë CEB-it raportet e saj financiare vjetore dhe gjysmë-vjetore ose semestrale, nëse këto raporte publikohen.

Neni 5

Përmbushja e detyrimeve të Huamarrësit

Pasi të paguhet shuma e plotë e principalit të kësaj Huaje dhe të gjithë interesat dhe shpenzimet që rrjedhin prej tyre, veçanërisht shumat sipas Neneve 6 dhe 7 më poshtë, Huamarrësi mund të lirohet plotësisht nga detyrimet e tij kundrejt CEB-it, me përjashtim të atyre të parashikuara në Nenet 4.2.1 dhe 4.2.3 më sipër për qëllimet e një vlerësimi të mundshëm të mëvonshëm të Projektit.

Neni 6

Interesi për vonesat

Për disbursimet në Euro dhe pavarësisht mjeteve të tjera që ka CEB-i në bazë të kësaj marrëveshjeje dhe Rregulloreve të Huasë, apo të tjera, nëse Huamarrësi nuk e paguan të gjithë interesin ose ndonjë shumë të pagueshme në bazë të Marrëveshjes brenda periudhës së parashikuar për pagesën, Huamarrësi duhet të paguajë interes shtesë për shumën e kërkueshme që nuk është paguar plotësisht, në normën EURIBOR një-mujor në datën e kërkueshme në orën 11 para dite (ora lokale e Brukselit), plus 2.5% në vit, që nga data e kërkueshme së kësaj shume deri në datën e pagesës përkatëse.

Shkalla e zbatueshme një mujore EURIBOR përditësohet çdo 30 ditë.

Neni 7

Shpenzimet dytësore

Të gjitha pagesat dhe taksat e të gjitha llojeve, të kërkueshme dhe të paguara, dhe të gjitha shpenzimet që rrjedhin ose nga përfundimi, ekzekutimi, likuidimi, i Marrëveshjes, plotësisht ose pjesërisht, ose ri-financimi i Huasë së dhënë, së bashku me të gjithë veprimet gjyqësore dhe jo-gjyqësore që kanë si origjinë këtë hua, përballohet nga Huamarrësi.

Megjithatë, dispozitat e Nenit 7.4 të Kapitullit 4 të Rregulloreve të Huasë zbatohen në lidhje me shpenzimet e procedurave të arbitrazhit të përmendur në Kapitullin 4.

Neni 8

Pari Passu dhe Mosmarrja e Zotimeve

Huamarrësi deklaron që asnjë detyrim tjetër nuk është marrë përsipër dhe nuk do të merret në të ardhmen që do t'i jepte një pale të tretë një renditje preferenciale, ose një të drejtë preferenciale pagese, kolateral ose garanci e çdo natyre që do t'u jepnin palëve të treta të drejta të avancuara (këtu e tutje referuar si Garancia).

Nëse kjo Garanci i jepet një pale të tretë, Huamarrësi bie dakord të formojë ose të japë një Garanci identike në favor të CEB-it ose, kur nuk e bën dot këtë, një Garanci ekuivalente dhe të parashikojë formimin e një Garancie të tillë në favor të CEB-it.

Mospërbushja e këtyre dispozitave do të përfaqësonte një rast vonese sipas parashikimit të Nenit 13-h të Kapitullit 3 të Rregulloreve të Huasë të CEB-it dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose shlyerjen e menjëhershme të huasë sipas kushteve të Neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të Rregulloreve të Huasë.

Neni 9

Përfaqësimet dhe Garancitë

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton:

- që organet e tij kompetente e kanë autorizuar atë të lidhë Marrëveshjen dhe i kanë dhënë nënshkruesit autorizimin për këtë, në pajtim me ligjet, dekretet, rregulloret, dispozitat e organizatave dhe teksteve të tjerë të zbatueshëm për të;

- që hartimi dhe përfundimi i Marrëveshjes nuk bie në kundërshtim me ligjet, dekretet, rregulloret, dispozitat e organizatave dhe teksteve të tjerë të zbatueshëm për të dhe të gjitha lejet, licencat dhe autorizimet e nevojshme për këtë janë marrë dhe mbeten të vlefshme për të gjithë periudhën e huasë.

Çdo ndryshim në lidhje me përfaqësimet dhe garancitë e mëposhtme, për të gjithë periudhën e huasë, duhet t'i njoftohet menjëherë CEB-it dhe t'i jepet çdo dokument shoqërues.

Neni 10

Raporti me palët e treta

Huamarrësi nuk mund të ngrejë asnjë fakt në lidhje me marrëdhëniet e tij me palët e treta në kuadrin e përdorimit të Huasë me qëllim që të mënjanojë përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje pjesërisht ose plotësisht.

CEB-i nuk mund të përfshihet në mosmarrëveshje që mund të lindin ndërmjet Huamarrësit dhe palëve të treta, dhe shpenzimet e çdo natyre të shkaktuara nga CEB-i për shkak të një kundërshtimi e veçanërisht të gjitha shpenzimet ligjore dhe gjyqësore përballohen nga Huamarrësi.

Neni 11

Interpretimi i Marrëveshjes

Huamarrësi deklaron që ai ka marrë një kopje të Rregulloreve të Huasë dhe është njohur me

ato.

Nëse ka një kontradiktë ndërmjet çfarëdo qoftë dispozite të Rregulloreve të Huasë dhe çdo dispozite të Marrëveshjes, do të mbizotërojnë dispozitat e Marrëveshjes.

Titujt e paragrafëve, seksioneve dhe kapitujve të Marrëveshjes nuk shërbejnë për interpretimin e tyre.

Në asnjë rast nuk prezumohet që CEB-i ka hequr dorë në heshtje nga ndonjë e drejtë në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Ligji i zbatueshëm

Marrëveshja, Shtojcat e saj dhe Marrëveshjet e Disbursimit në lidhje me të rregullohen nga rregullat e CEB-it sipas parashikimit të dispozitave të Nenit 1, paragrafi 3, të Protokollit të Tretë (të datës 6 mars 1959) të Marrëveshjes së Përgjithshme për Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës (e datës 2 shtator 1949) dhe, së dyti, sipas rastit, ligjit francez.

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve në Marrëveshje i nënshtrohen arbitrazhit në kushtet e parashikuara në Kapitullin 4 të Rregulloreve të Huasë.

Neni 13

Ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit

Palët kontraktuese bien dakord të mos përdorin asnjë privilegj, imunitet apo legjislacion para një autoriteti juridiksional ose tjetër, vendas ose i huaj, me qëllim që të kundërshtojnë ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi të dhënë në kushtet e parashikuara në Kapitullin 4 të Rregulloreve të Huasë.

Neni 14

Njoftimet

Çdo njoftim ose komunikim tjetër që i jepet ose i bëhet CEB-it ose Huamarrësit në bazë të kësaj Marrëveshjeje bëhet me shkrim dhe mendohet të jetë dhënë ose bërë rregullisht nëse ai jepet dorazi, postë ajrore ose faks nga njëra palë drejtuar tjetrës në adresën e palës të përcaktuar më poshtë.

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Tiranë, Republika e Shqipërisë

Në vëmendje të: Ministrit të Financave

Fax. ++355 42 228 494

Për CEB-in:

Council of Europe Development Bank

55 Avenue Kleber

75116 Paris

Në vëmendje të: Drejtor i Përgjithshëm për Huatë

Fax +33 1 47 55 37 52.

Të gjitha komunikimet jepen ose bëhen në gjuhën angleze.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga CEB-i dhe Huamarrësi dhe ratifikimin e saj nga Parlamenti Shqiptar.

Neni 16

Kopjet origjinale të Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale, secili prej të cilëve është njëlloj i barasvlershëm.

Një kopje origjinale mbahet nga secila prej palëve kontraktuese.

Tiranë

Më _____

Për Republikën e Shqipërisë

Huamarrësi

Paris

Më _____

Për CEB-in

Guvernatori/Zëvendësguvernatori

LISTA E SHTOJCAVE

SHTOJCA 1	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT
SHTOJCA 2a/b	LETËR SHOQËRUESE (MODEL)
SHTOJCA 3	PARIMET E MENAXHIMIT TË AMBIENTIT
SHTOJCA 4	IDENTIFIKIMI I NËN-PROJEKTEVE TË PËRSHTATSHËM INDIVIDUALË (MODEL)
SHTOJCA 5	RAPORTET E MONITORIMIT (MODEL)

Shtojca 1
Përshkrimi i Projektit

I.	F/P :	1649 (2008)
	Huamarrësi:	Republika e Shqipërisë
	Aprovimi nga Këshilli Administrativ	21 nëntor 2008
	Shuma e aprovuar:	5 000 000 Euro
II.	Zona e ndërhyrjes:	Krijimi dhe ruajtja e vendeve të mundshme të punës
	Punët e Planifikuara:	Projekti i jep MAFF-it burimet financiare për t'ua dhënë hua sipërmarrësve të vegjël në zonat rurale për të lehtësuar blerjen e bagëtisë, veglave dhe mjeteve bujqësore; investimet e vogla rurale (p.sh, sera, furra buke), dhe tregti dhe shërbime të vogla. Fondet e CEB-it do të përdoren për të dhënë dy lloje huash: “hua individuale” (më pak se 1200 Euro), veçanërisht në lidhje me bizneset e pa-licencuara në fushën bujqësore dhe “huatë e ndërmarrjeve të vogla” (më shumë se 1200 Euro) në lidhje me bizneset e licencuara si tregtia dhe përpunimi i ushqimit në zonat rurale. Huatë e MAFF-it mund të përdoren për shpenzimet vetëm për qëllime biznesi.
	Agjencia e Zbatimit të Projektit	MAFF-i u krijua nga Qeveria e Shqipërisë me mbështetjen e Fondit Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor (IFAD), si Fondacion, në dhjetor 1999 dhe u licencua nga Banka e Shqipërisë si një Institucion Financiar Jo-Bankar në mars 2002. Mandati i MAFF-it është operimi si një institucion i qëndrueshëm financiar për të ofruar shërbimet e nevojshme të kredisë për popullatën rurale dhe peri-rurale, veçanërisht në zonat malore, me qëllimin e gjerë të zbutjes së varfërisë dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik.
	Vendndodhja:	Në të gjithë Shqipërinë, zonat rurale dhe malore.
	Kostoja e Plotë e Projektit:	10 000 000 Euro
	Plani i financimit:	Vlera e projektit të propozuar duhet të jetë të paktën 10 milion Euro, ku CEB-i do të japë 5 milion Euro, d.m.th, deri në 50% të fondeve që nevojiten për nën-projektet. Pjesa tjetër duhet të vijë nga përfituesit, fondet e MAFF-it ose nga burime të tjera, duke përfshirë IFI-në.
	Ecuria e punëve në kohën e zbatimit të huasë:	0%
	Afati i punëve:	2009 – 2011
	Kushte të veçanta	Kufiri maksimal i nën-huasë së dhënë nga MAFF-i për përfituesit e fundit është caktuar në 60 000 Euro. MAFF-i siguron që fondet e CEB-it të caktuara në çdo nën-projekt të mos kalojnë 50% të kostos totale të pranueshme të nën-projektit. MAFF-i do të marrë parasysh avantazhin e marrë nga financimi i CEB-it dhe për të kaluar këtë avantazh tek përfituesit e fundit, duke marrë parasysh faktin që një marzh ndërmjetës mund të zbatohet për të mbuluar riskun dhe shpenzimet e menaxhimit. Projektet e përfituesve të fundit mund të konsiderohen të përshtatshëm nëse huatë e veçanta janë nënshkruar me MAFF-in jo më parë se data 21 nëntor 2007. Afatet e transheve të CEB-it mund të jenë deri në 15 vjet duke përfshirë 5 vjet pa interesa. Duke qenë se afatet e përfituesve të fundit janë më të shkurtër, MAFF-i i jep hua fondet e CEB-it tek të njëjtat kategori të përfituesve nëpërmjet një mekanizmi kthyes.
III.	Kriteret e përshtatshmërisë: (sipas zonës së ndërhyrjes)	Për të qenë i përshtatshëm për financimin e CEB-it, projektet duhet të kenë investime fikse ose investime në pajisje produktive, duke përfshirë formën e qiradhënies, që synon krijimin ose ruajtjen e punëve të përhershme ose sezonale. CEB-i mund të financojë gjithashtu “kërkesat e kapitalit të punës” brenda kufirit 12.5% të huasë individuale të dhënë përfituesit të fundit. Përshtatshmëria përjashtohet për investimet për armë, energji nukleare, duhan, prodhim pijesh alkoolike, lojëra fati, pornografi, dhe produkte të konsideruara nga rregulloret e Bashkimit Evropian të dëmshme për shëndetin dhe ambientin.

IV.	Efektet Sociale: (sipas zonës së ndërhyrjes)	Duke dhënë financim për ndërmarrje shumë të vogla dhe të vogla, biznese të reja dhe fermerët e vetëpunësuar, Projekti i propozuar duhet të ndihmojë për të filluar zhvillimin ekonomik në rajonet më të varfra të Shqipërisë duke u përqendruar në anën e dobët të tregut shqiptar. Projekti do të mbështeste zhvillimin e aktiviteteve të biznesit shumë të vogël në zonat rurale që kanë një raport të ulët “kapital me fuqinë punëtore” dhe që janë veçanërisht të efektshme në krijimin e punësimit për një nivel të caktuar investimi. Kështu Projekti ndihmon në mbylljen e një boshllëku financimi që ka penguar rritjen e bizneseve të vogla. Vlerësohet që Huaja e CEB-it do të lejojë një rritje të cilësuar afërsisht 34% në numrin e punëve të krijuara/ruajtura nëpërmjet aktiviteteve, duke i mundësuar MAFF-it afërsisht 14800 punë të krijuara/ruajtura në afërsisht 3 vjet aktivitet, gjatë zbatimit të Projektit.
------------	---	--

Shtojca 2 A

LETËR SHOQËRUESE MODEL PËR NJË HUA ME NORMË FIKSE

F/P 1649 – [numri] transh

BANKA E ZHVILLIMIT E KËSHILLIT TË EVROPËS

LETËR SHOQËRUESE

Në kuadrin e Marrëveshjes së Huasë e datës [data]

Ndërmjet BANKËS SË ZHVILLIMIT TË KËSHILLIT TË EVROPËS

(këtu quhet “CEB”)

dhe

Republikës së Shqipërisë

(këtu quhet “Huamarrësi”)

Kjo Letër Shoqëruese dhe Marrëveshja Kuadër e Huasë përcaktojnë afatet dhe kushtet e miratuara për [numër] transh-in duke iu referuar Nenit 3 të Marrëveshjes Kuadër të Huasë.

Shuma e Huasë

Euro [shuma]

Maturimi

[numër] vit maturimi përfundimtar me një [numër] vitesh afat pa pagesë

Norma Fikse e Interesit

[përqindja] (neto) në vit

Pagesa e interesit

gjysmë vjeçare ose vjeçare për pagesat e prapambetura

Fraksioni i Numërimit të Ditëve

30/360 e pandryshuar, Konventa e Modifikuar e Ditës Pasuese

së Punës

Ditë e Punës

si[përcaktohet në Marrëveshjen Kuadër të Huasë

Data e Disbursimit

[data]

Udhëzimet e Pagesës (Huamarrës)

Numri i llogarisë [numër] ose [emri i Bankës dhe qyteti]

SWIFT CODE: [shifër] nëpërmjet [emri bankës dhe qytetit përkatës]

SWIFT CODE [shifër]

Udhëzimet e Pagesave (CEB) Sipas nenit 3.4 të Marrëveshjes Kuadër të Huasë

Pagesat për interesin dhe principalin do të bëhen në pajtim me Grafikun e bashkangjitur të Shlyerjeve. Ndërsa interesi do të paguhet për herë të parë më (datë), principalin do të shlyhet për herë të parë më (datë).

Të gjitha pagesat do të bëhen në llogarinë e CEB-it sipas Udhëzimeve të Pagesës (CEB) të përshkruar më sipër.

Këto dispozita i nënshtrohen marrëveshjes “Konventës së Modifikuar të Ditës Pasuese të Punës”, përkufizimi i së cilës gjendet në Marrëveshjen Kuadër të Huasë, të nënshkruar ndërmjet CEB-it dhe Huamarrësit në [datë].

[Qyteti, datë]

[Qyteti, datë]

Për Bankën e Zhvillimit

Për Republikën e Shqipërisë

të Këshillit të Evropës

Shtojca 2 B

LETËR SHOQËRUESE MODEL PËR NJË HUA ME NORMË VARIABËL

F/P 1649 – [numri] Transh

BANKA E ZHVILLIMIT E KËSHILLIT TË EVROPËS

LETËR SHOQËRUESE

Në kuadrin e Marrëveshjes së Huasë e datës [data]

Ndërmjet BANKËS SË ZHVILLIMIT TË KËSHILLIT TË EVROPËS

(këtu quhet “CEB”)

dhe

Republikës së Shqipërisë

(këtu quhet “Huamarrësi”)

Kjo Letër Shoqëruese dhe Marrëveshja Kuadër e Huasë përcaktojnë afatet dhe kushtet e miratuara për [numër] transh-in duke iu referuar nenit 3 të Marrëveshjes Kuadër të Huasë.

Shuma e Huasë

Euro [shuma]

Maturimi

[numër] vit maturimi përfundimtar me një [numër] vitesh afat

	pa interesa
EURIBOR	[fut përkufizimin e EURIBOR]
Norma Variabël e Interesit	EURIBOR 3 ose 6 muaj plus ose minus [numër] pikë bazë [neto] në vit (Telerate [referimi] ose Reuters [referimi])
Pagesa e interesit	semestrare ose gjysmë viti për pagesat e prapambetura
Fraksioni i Numërimit të Ditëve	aktuale/360, Konventa e Modifikuar e Ditës Pasuese së Punës
Ditë e Punës	si[përcaktohet në Marrëveshjen Kuadër të Huasë
Data e Disbursimit	[data]
Udhëzimet e Pagesës (Huamarrës)	Numri i llogarisë [numër] ose [emri i Bankës dhe qyteti] SWIFT CODE: [shifër] nëpërmjet [emri bankës dhe qytetit përkatës] SWIFT CODE [shifër]
Udhëzimet e Pagesës (CEB)	Sipas Nenit 3.4 të Marrëveshjes Kuadër të Huasë

{Tekst për normën bazë të EURIBOR-it dhe struktura e huasë amortizuese.

Norma e interesit do të llogaritet për secilin afat mujor [numër], duke filluar nga data e disbursimit. Interesi do të caktohet dy ditë pune para secilës periudhe të re interesi. CEB-i do të informojë Huamarrësin në lidhje me interesin e pagueshëm çdo [numër] muaj. Pagesa e interesit do të bëhet më [dita, muaji]¹ çdo vit, dhe për herë të parë më [datë]. ***[rendisni datat e pagesës dhe shumën principale për secilën datë]***

Të gjitha pagesat do të bëhen në llogarinë e CEB-it sipas Udhëzimeve të Pagesës (CEB) të përshkruar më sipër.

Këto dispozita i nënshtrohen marrëveshjes “Konventës së Modifikuar të Ditës Pasuese të Punës”, përkufizimi i së cilës gjendet në Marrëveshjen Kuadër të Huasë, të nënshkruar ndërmjet CEB-it dhe Huamarrësit në [datë].

[Qyteti, datë]

Për Bankën e Zhvillimit
të Këshillit të Evropës

[Qyteti, datë]

Për Republikën e Shqipërisë

Shtojcë 3 PARIMET E CEB-IT PËR MENAXHIMIN E MJEDISIT

- Qëllimi i parimeve për analizimin e aspekteve mjedisore të paraqitur më poshtë, është si vijon:
1. Sigurimi që projektet e financuara nga Banka të kenë kaluar kontrollin paraprak për mjedisin (vlerësimi paraprak) dhe që aspektet e tyre mjedisore të jenë marrë parasysh;
 2. mënjanimi i rreziqeve mjedisore dhe mosmarrëveshjeve që mund të rrezikojnë zbatimin dhe

¹ përmend 4 data për pagesa semestrare dhe 2 data për pagesa gjysmë-mujore.

funksionimin e Projektit;

3. sigurimi që shpenzimet në lidhje me masat përkatëse për mbrojtjen e mjedisit të vlerësohen dhe integrohen në shpenzimet e përgjithshme të projektit.

Huamarrësi duhet të japë të gjithë informacionin e nevojshëm për vlerësimin e ambientit të projektit.

Projektet e zbatuara në një Shtet Anëtar të Bashkimit Evropian ose një Shtet Aderues ose në një vend që i përket Hapësirës Ekonomike Evropiane (EES) duhet të jetë në pajtim me rregullat evropiane të ambientit, parimet kryesore të të cilëve janë:

- parimi i kujdesit, parimi i parandalimit, parimi sipas të cilit prioritet i jepet trajtimit të problemeve të ambientit në burim, dhe parimi “ndotësi paguan”;

- Direktivat Evropiane në lidhje me studimet e ndikimit në ambient (EIS);

- Direktivat Evropiane në lidhje me prodhimin industrial, menaxhimin e ujit dhe mbeturinave, ndotjen e tokës dhe ajrit dhe mbrojtjen e natyrës.

Për më tepër, projektet duhet të respektojnë të gjitha konventat dhe marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare.

Për projektet e zbatuara në një shtet anëtar tjetër të CEB-it, duhet të zbatohen të njëjtat parime, në pajtim me përputhshmërinë e tyre me kushtet dhe ligjet vendase.

Dispozitat për analizimin e aspekteve mjedisore të zbatueshme për të gjithë projektet, janë si më poshtë:

A. Ndikimi Mjedisor

- Çdo projekt duhet t'i nënshtrohet një kontrolli paraprak për çdo dëmtrim të mundshëm që mund t'i shkaktojë mjedisit;

- Kjo analizë duhet ta bëjë të mundur klasifikimin e projekteve sipas kriterëve përkatëse sipas përcaktimit në Direktivën 85/337/CEE në lidhje me vlerësimin e ndikimit mjedisor të projekteve të caktuara publike dhe private;

- Një Studim i Ndikimit Mjedisor duhet të kryhet nga një organ i pavarur në rastin e projekteve, zbatimi dhe/ose funksionimi i të cilëve kanë një potencial të konsiderueshëm për të dëmtuar mjedisin.

B. Rreziqet për mjedisin

- Çdo projekt duhet t'i nënshtrohet kontrollit paraprak për rreziqet për mjedisin që mund të rrezikonte zbatimin dhe/ose funksionimin korrekt të tij;

- Disa shembuj jo-shterues të projekteve të rrezikshëm janë ata të zbatuar për:

- Tokën e lirë industriale të mëparshme (rreziqet e tokës dhe ujërave nëntokësorë të ndotura)

- Trojet pranë instalimeve të rrezikshme;

- Zonat sizmike (rreziqet nga tërmetet, shkarjet e tokës etj).

- Për çdo projekt që mund të ekspozohet ndaj rreziqeve thelbësore të mjedisit, duhet të kryhet një Diagnostikim të Ambientit (ED);

ED-ja duhet të përfshijë një analizë të masave të marra për të kaluar rreziqet e shkaktuara mjedisore.

Shtojca 5 – Raporti i Global i Monitorimit

KRIJIMI I VENDEVE TË PUNËS

Pasqyra e Monitorimit të Huasë

F/P1649(2008) - MAFF - ALBANIA

Kësti nr	_____	Ruajtja e vendeve të punës
paguar në	_____	Krijimi i vendeve të punës
Hua e autorizuar e CEB-it	_____	Totali i përdorur/dhënë (%)
Huaja e CEB-it paguar në	_____	Numri i klientëve fundorë
Norma e interesit	_____	Norma mesatare e nën-huasë
Maturimi	_____	Maturimi mesatar

NDARJA E HUASË SIPAS SEKTORIT TË AKTIVITETIT

SEKTORI I AKTIVITETIT	HUAJA CEB	%	KOMENTE

LOAN BREAKDOWN BY SIZE OF ENTERPRISE

MADHËSIA E NDËRMARRJES	HUAJA CEB	%	KOMENTE

LOAN BREAKDOWN BY REGION/DEPARTEMENT/MUNICIPALITY

RAJONI/DEP/BASHKIA	HUAJA CEB	%	KOMENTE

LOAN BREAKDOWN BY TYPE OF INVESTMENT

INVESTIME	HUAJA CEB	%	KOMENTE
Blerja e tokës			
Ndërtim			
Infrastruktura dhe impiante			
Makinë dhe pajisje			
Automjete			
Të tjera			

UDHËZIM
Nr.2, datë 14.5. 2009

**PËR KRITERET E KONKURRIMIT DHE PROCEDURËN E DHËNIES NË PËRDORIM
ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9385 datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të nenit 17 të ligjit nr.9693, datë19.3.2007 “Për fondin kullisor”, të ndryshuar dhe nenit 23 të ligjit nr 7875, datë 23.11.1994, “Për Mbrojtjen e Faunës së Egër dhe Gjuetinë”, të ndryshuar.

UDHËZOJ:

1. Dshp-te studjojnë dhe propozojnë në Ministri, brenda muajit Nentor, sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullisor që mund të jepen në përdorim për vitin pasardhës.

2. Në vlerësimin e sipërfaqeve të fondit pyjor e kullisor që mund të jepen në përdorim, dshp-te mbajnë parasysh që:

a) Sipërfaqet mund të jepen vetëm për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në nenin 19 të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, dhe në nenin 17 të Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullisor”, i ndryshuar;

b) Veprimtaritë që do të ushtrohen në këto sipërfaqe, të jenë në harmoni me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mos vijnë në kundërshtim me planet e tyre të mbarshimit;

c) Afati i dhënies në përdorim të jetë në përputhje me afatin e planit të mbarshimit dhe jo më shumë se 10 vjet;

d) Sipërfaqja që do të jepet në përdorim të mos jetë më e vogël se madhësia limit e një nengastre (0,5 ha.).

e) Projektet e veprimtaritë që do të ushtrohen të sjellin përmirësime të dukshme në mbarështrimin e flores dhe faunës që jeton në këto sipërfaqe;

f) Projektet e veprimtaritë të realizojnë investime që përmiresojnë tregues biologjikë dhe të infrastrukturës së zonës;

g) Projektet e veprimtaritë të respektojnë kërkesat dhe elementët e nevojshëm për strehim, ushqim, foljezim, qetësi, etj., të llojeve të faunës së egër që jetojnë në zonë;

h) Projektet e veprimtaritë të mos cenojnë vlerat dhe funksionet natyrore e biologjike të zonës.

i) Projektet e veprimtaritë të jenë në përputhje me investimet publike që janë planifikuar të behen në zonë në 10 vitet e ardhshme

3. Për çdo sipërfaqe që mendon të jepet në përdorim, dshp sugjeron edhe llojin e veprimtarisë që mund të ushtrohet në të dhe përgatit studimin, i cili përmban:

a) Sipërfaqen e fondit pyjor ose kullisor e shprehur në m² (ha), me kufij të përcaktuar qartë në hartë të shkallës 1:10000 ose 1:25000 (koordinatat gjeografike, metrike),

b) Treguesit identifikues (kadastral) të ngastrave ose n/ngastrave.

c) Karakteristikat silvikulturale të grumbullit pyjor.

d) Treguesit tekniko-ekonomik për kullotat dhe livadhet.

e) Treguesit e vlerës për çdo njësi kadastrale të pyjeve dhe kullotave që parashikohet të jepet me qira.

f) Vlerën dysheme të qirasë për ha/vit ose m²/vit.

g) Sipërfaqja që studiuar për tu dhënë në përdorim të mos jetë objekt pretendimi për rikthimin e pronës ish-pronarëve;

h) Sipërfaqja të mos jetë objekt tjetërsimi në një afat 10 vjeçar si pasoje e investimeve publike.

4. Pas shqyrtimit të propozimeve të dshp-ve, drejtoria perkatese teknike në Ministri, brenda muajit Dhjetor, i përcjell ato të Ministri për miratim dhe pas miratimit, njoftohet drejtoria perkatese të

sherbimit pyjor, qe te beje shpalljen e tyre me qellim qe subjektet te shfaqin interes dhe te paraqesin ofertat e tyre, ne dshp-ne perkatese.

5. Njoftimi shpallet 2 herë në Buletin e Njoftimeve Publike dhe përmban të dhënat për sipërfaqen, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacionin, që duhet të paraqesin konkurrentët, si dhe vendin, datën e orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 ditë kalendarike nga data e botimit të fundit

6. Ofertat qe paraqesin subjektet qe duan te konkurrojnë per te marre siperfaqe ne perdorim, permbajne Kerkesen me gjeneralitetet e kerkuesit (emri, emri i shoqerise, adresa, tel/fax.), nje pershkrim te shkurter te veprimtarise qe do te ushtrohet, sasine e siperfaqes dhe kohen qe do ta perdori.

7. Kerkesa shoqerohet nga dokumentat e meposhtem:

a) Fotokopje e noteruar e regjistrimit ne QKR;
b) Projektin teknik që hartohet nga specialistë të licënuar, dhe që trajton të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
c) Plan biznesin dhe investimet qe do behen;
d) Autodeklarimin e kerkuesit qe i ka stafin, makimerite dhe pajisjet per veprimtarine qe do ushtroje;

e) Planin e rehabilitimit te siperfaqes dhe kthimin e saj ne gjendjen e meparshme;

f) Nivelin e punesimit ne veprimtari;

g) Masen e qirase per ha/vit.

8. Kushtet e pjesëmarrjes ne konkurrim janë:

a) Garanci financiare te mjaftueshme për përballimin e investimeve te parashikuara ne plan biznes;

b) Prania e specialistit te fushës, nëpërmjet CV-së profesionale, ku të tregohet përvoja ne fushën e veprimtarisë;

c) Autodeklarim se subjekti nuk ka procese gjyqësore ne ngarkim, detyrime tatimore ose detyrime te tjera.

9. Kriteret e konkurimit në dhënien me qira të sipërfaqeve fond pyjor dhe kullosor janë:

a) Projekti teknik i veprimtarise qe do te ushtrohet

b) Plan biznesi dhe investimet qe do behen

c) Planin e rehabilitimit te siperfaqes

d) Nivelin e punesimit ne veprimtari

e) Masen e qirase per ha/vit

10 Për vlerësimin e kërkesave të paraqitura, në DSHP vepron Komisioni i Vlerësimit i cili ngrihet me Urdhër te Drejtorit qe përmban:

a) Të dhënat e zonës: emërtimi, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, çmimi dysHEME, afati;

b) Veprimtarinë, që mund të ushtrohet ne ketë sipërfaqe;

c) Pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, të përcaktuara sipas pikës 8 të këtij urdhri;

d) Vendin, datën dhe orën, ku paraqiten dokumentet;

e) Përbërjen e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve i cili ne çdo rast përbëhet nga jo me pak se pese anëtarë, specialiste te drejtorisë.

f) Dokumentacionin, që do të paraqitet ne konkurrim nga konkurrentet.

11 Komisioni i vlerësimit ka këto detyra:

a) Hap, në prani të konkurentëve, dokumentacionin e paraqitur prej tyre duke bërë te njohur të dhënat kryesore për çdo ofertë të paraqitur. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, konkurenti skualifikohet, në prani të tij.

b) Harton procesverbalin e zhvillimit të konkurimit, ku përshkruan pjesëmarrësit, konkurentët e skualifikuar dhe shkakun, konkurentët e kualifikuar dhe listën e dokumenteve të paraqitura prej tyre.

c) Brenda 10 ditëve, bën shqyrtimin e ofertave të paraqitura dhe vlerëson me pikë çdo element konkurimi.

ç) Në përfundim, konkuruesit renditen në bazë të pikëve të përfituara.

d) Paraqet, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c”, të kësaj pike, te drejtori, një

informacion për zhvillimin e konkurimit, së bashku me procesverbalin e zhvillimit të konkurimit dhe listën e konkuresve, të renditur sipas pikëve të fituara.

12 Vlerësimi i ofertës mbështetet ne grumbullimin e pikëve si me poshtë:

- a) Projekti teknik i veprimtarise qe do te ushtrohet 30 pikë;
- b) Plan biznesi dhe investimet qe do behen 15 pikë;
- c) Planin e rehabilitimit te siperfaqes 15 pikë;
- d) Nivelin e punesimit ne veprimtari 10 pikë;
- e) Masen e qirase per ha/vit 30 pikë.

13 Komisioni vendos për subjektin fitues të konkurimit. Njoftimi për shpalljen fitues vendoset në këndin e njoftimeve të Drejtorise se Sherbimit Pyjor.

14 Subjektet konkuresve, brenda 5 ditëve nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimit te Drejtori, i cili, brenda 10 ditëve, i përgjigjet ankuesit me shkrim.

15 Pas përfundimit të procedurave të mësipërme, me fituesin lidhet kontrata e qirasë brenda 10 diteve. Ne se fituesi nuk e lidh kontraten brenda ketij afati, kontrata lidhet me subjektin qe eshte renditur i dyti ne listen e konkurimit.

16. Siperfaqia dorezohet me proces-verbal dhe ne perfundim te perdorimit merret ne dorezim nga dshp po me proces-verbal.

17. Kontrata e qirase, veç te tjerash, permban detyrimin e qiramarresit:

- a) Per te zbatuar projektin, planin e investimeve dhe te rehabilitimit te siperfaqes se perdorur;
- b) Per te ruajtur mjedisin rrethues nga ndotjet dhe demtimet qe mund te shkaktoj veprimtaria e tij;

c) Per te siguruar mbrojtjen nga zjarri dhe angazhimin ne shuarjen e tij;

d) Per te informuar me shkrim dshp 1 vit per ecurine e veprimtarise e problemet qe dalin;

18. Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë ne vitet pasardhës.

19. Të ardhurat e siguruar nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore e kullimore administrohen sipas shkronjës “b” të pikës 1 të vendimit nr. 432, datë 28.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.

20. Kur kërkesa behet për mbarështimin e faunës se egër dhe gjueti turistike, sipërfaqja e kërkuar nuk duhet te jete me e vogël se 40 ha, nuk duhet te ndodhet ne zonat e mbrojtura dhe projekti teknik duhet te trajtoje:

a) Sigurimin e rritjes dhe mbarështimin e një ose më shumë llojeve të faunës së egër;

b) Garantimin e strehimit natyror, ushqimin në natyrë dhe ushtrimit të aktivitetit të gjuetisë sipas ligjeve në fuqi;

c) Kushtet e jetesës në rast të mbajtjes së faunës në gjendje te mbyllur;

d) Garantimin e bimësisë natyrore të mjaftueshme në sasi për ushqimin e llojeve të faunës kryesore gjatë gjithë vitit, duke pranuar një ushqim plotësues gjatë një periudhe të caktuar të vitit;

e) Përmbushjen e tre kushteve kryesore: të mbrojtë gjahun nga dëmtuesit, nga faktoret klimatike si dhe të sigurojë kushte për riprodhim.

f) Programin për vetëmonitorimin e veprimtarisë gjatë zbatimit të projektit.

g) Planin për përballimin e emergjencave, aksidenteve dhe fatkeqësive natyrore.

21. Subjektet mund te synojnë te ushtrojnë veprimtari ne sipërfaqet e fondit pyjor ose kullisor, duke paraqitur, ne çdo kohe, kërkesën ne formën e propozimit te pa kërkuar. Edhe ne këto raste kërkesa e tyre do ti nënshtrohet procedurës se konkurimit.

22. Për administrimin e kërkesave ne këto raste, d sh p kryen këto detyra:

a) I bën te qarte kërkesit se sipërfaqja e kërkuar për atë lloj veprimtarie, do te shpallet për konkurrim për një afat 1 mujor.

b) Përgatit raportin teknik për sipërfaqen e kërkuar

c) Npërmjet drejtorisë përkatëse teknike te Ministrisë, merr miratimin e Ministrit për dhënien ne përdorim te siperfaqes se kërkuar;

d) Shpall sipërfaqen për konkurrim;

e) Njofton kërkesin te përgatisë dosjen për konkurrim sipas kërkesave te pikës 7 te këtij udhëzimi.

23. Komisioni i shqyrtimit i dshp, administron ofertat qe mund te paraqiten, ne përputhje me

kërkesat e pikës 11,12 te këtij udhëzimi dhe shpall fituesin me te cilin lidhet kontrata e qirasë për sipërfaqen qe jepet ne përdorim. Ne se gjate 1 muaji nuk paraqiten ofertues te tjerë, kontrata lidhet me kërkuesin, duke mbajtur parasysh kërkesat e pikës 16, 17 te këtij udhëzimi.

24. Përjashtohen nga konkurrimi:

- a) Dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 1000m² dhe me afat deri 1 vit.
- b) Subjektet qe kane marre leje shfrytëzimi të pasurive natyrore minerare, të ujërave dhe veprimtarive te tjera të ngjashme, kur këto sipërfaqe u jepen për zhvillim të veprimtarisë qe është pajisur me leje nga organi i ngarkuar me ligj.
- c) Në rastet kur me ligj, me VKM, me vendim te KRRT-se ose me marreveshje koncesionare, subjektit i eshte dhene leja e ushtrimit te veprimtarise. Ne keto raste subjekti i pajisur me leje lidh direkt kontratën e qirase për sipërfaqen ku do te ushtroj veprimtarinë, duke mbajtur parasysh kërkesat e pikës 11 te këtij udhëzimi.

25. Për të lidhur kontraten e qirase ne rastet e pikes 24 me siper te ketij udhezimi, Subjekti paraqet pranë dshp-së dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën për marrjen me qira të sipërfaqes;
- b) Projektin teknik, plan biznesin dhe investimet për zhvillimin e aktivitetit, të miratuara;
- c) Planin e rehabilitimit te siperfaqes dhe kthimin e saj ne gjendjen e mëparshme;
- d) Lejet për ushtrimin e aktivitetit dhe lejen e mjedisit ne se veprimtaria qe do te ushtroje ka ndikime negative ne mjedis.

26. Për kërkesat sipas pikës 24 te këtij udhëzimi, Dshp e shqyrton dosjen brenda 15 ditëve dhe, kur e gjen te rregullt, harton raportin teknik dhe e paraqet dosjen për miratim te Ministri. Pas miratimit, d sh p dhe kërkuesi nënshkruajnë proces-verbalin e dhënies se siperfaqes dhe kontratën e qirasë.

27. Kërkesat dhe procedurat e këtij udhëzimi mund te përdoren edhe nga njësite e qeverisjes vendore, kur japin ne përdorim sipërfaqe te pyjeve dhe kullotave komunale.

28. Me hyrjen ne fuqi te këtij udhëzimi, udhëzimi nr. 6, datë 2.10.2007, “Për rregullat dhe procedurat e dhënies ne përdorim te fondit pyjor e kulllosor” si dhe udhëzimi nr. 5 datë 24.09.2007, “Për dhënien ne përdorim te fondit pyjor për mbarështimin e faunës se egër”, shfuqizohen.

29. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoritë teknike ne Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe d sh p -të.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter XHUVELI

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë

Hyri në shtyp më 14.5.2009
Doli nga shtypi më 14.5.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADELPRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 24 lekë